



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice**

---

Në bazë të Ligjit nr. 08/1-033 për Provimin e Jurisprudencës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 13/2013 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë publikon:

**SHPALLJEN PËR APLIKIM**  
**PËR DHËNIEN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS**

Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar, të cilët dëshirojnë që të aplikojnë për dhënie e Provimit të Jurisprudencës që do të mbahet në **muajin Shtator 2022**, se:  
Afati për dorëzimin e Kërkesës dhe dokumentacionin përkatës për aplikim për Provim të Jurisprudencës fillon prej datës **05 shtator 2022 deri me 12 Shtator 2022**.

**I.** Kërkesës për paraqitjen e Provimit të Jurisprudencës e cila merret në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, duhet t'i bashkëngjisni dokumentet e **vërtetuara te Noteri** me të cilat dëshmohet se i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 8 të Ligjit nr. 08/1-033 për Provimin e Jurisprudencës, si në vijim:

1.Kërkesën për aplikim për Provim të Jurisprudencës, e cila mund të sigurohet duke e shkarkuar ne këtë link <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>

2.Diplomën e Fakultetit Juridik, e cila duhet të jetë kopje e Noterizuar;

3.Vërtetimin për përvojën e punës/praktikes i cili duhet të dëshmoi përvojën e saktë të punës/praktikes dhe duhet të dorëzohet origjinali apo kopje e Noterizuar;

4.Certifikatën e Shtetësisë së Republikës së Kosovës;

5.Kopjen e letërnjoftimit;

6.Nëse kandidati fakultetin e ka të përfunduar jashtë vendi, atëherë kandidati duhet ta sjell diplomën e nostrifikuar dhe Vendimin nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës. Diploma dhe Vendimi duhet të dorëzohen në kopje të Noterizuara.

7. Kandidati nga shteti i huaj i cili ka të kryer Fakultetin Juridik në ndonjë institucion të arsimit të lartë të akredituara në Republikën e Kosovës dhe aplikon për Provim të Jurisprudencës, përveç dokumenteve që duhet ti dorëzon nga pikat 1,2 dhe 3 të kësaj Shpallje për Aplikim për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, duhet të dorëzon edhe kopjen e Noterizuar të lejes së qëndrimit në Republikën e Kosovës.

Dokumentacioni i kërkuar më lart dhe i dorëzuar për lejimin e dhënies së Provimit të Jurisprudencës, nuk i kthehet kandidatëve. Dokumentacioni **i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje**, është bazë që Komisioni të refuzoj Kërkesën për lejimin e dhënies së Provimit të Jurisprudencës.

**II.** Kandidatët të cilët kanë mbetur në **riprovim** nga afati i qershorit 2022 duhet ta paraqesin **VETËM KËRKESËN** brenda këtij afati për t'iu nënshtruar Riprovimit në afatin e Shtatorit 2022. Kërkesën për **riprovim** mund të sigurohet në këtë link: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>

**III.** Kandidatëve të cilëve me parë iu është aprovuar kërkesa për dhënien e Provimit të Jurisprudencës, e të cilët dëshirojnë t'iu nënshtrohen Provimit në këtë afat, duhet të paraqesin **VETËM KËRKESËN** për dhënien e Provimit të Jurisprudencës, e cila mund të sigurohet në këtë link: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46> kërkesa duhet të përmbajë të dhënat personale numrin dhe datën e Vendimit me të cilin i është mundësuar hyrja në Provim të Jurisprudencës dhe vitin në të cilin i është lejuar dhënia e Provimit të Jurisprudencës.

Kërkesa për dhënien e Provimit të Jurisprudencës dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë, Ish-Ndërtesa e Rilindjes, kati përdhese, Arkivi i Ministrisë së Drejtësisë, Prishtinë, Republika e Kosovës, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri 16:00, apo përmes Postes.

Kandidatit me vendim i lejohet hyrja në Provimin e Jurisprudencës. Për Vendimin, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së provimit me shkrim dhe me gojë, kandidatët do të njoftohen përmes **E-MAIL ADRESËS**, të cilën ju lutem ta shënoni qartë dhe saktë gjatë aplikimit, pasi komunikimi do behet vetëm përmes e-mailit.

Çdo njoftim për Provimin e jurisprudencës që ka të bej me publikimin e rezultateve të Provimit të Jurisprudencës, do të behet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë vetëm me numër të protokollit të cilin do e pranoni me rastin e aplikimit për Provim të Jurisprudencës në Arkivin e Ministrisë së Drejtësisë. Andaj ju lutem që këtë numër të protokollit ta pranoni dhe ta ruani me qellim që të identifikoni rezultatin tuaj të Provimit të Jurisprudencës kur do që publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Për informata të hollësishme mund të drejtoheni në faqen zyrtare te Ministrisë së Drejtësisë <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>